



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AVOKATURA E SHTETIT
KOLEGJI I AVOKATURËS SË SHTETIT

Nr. 1143 Prot.

Tiranë, më 28.03.2019

V E N D I M

Nr. 1, datë 28.03.19

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOLEGJIT
TË AVOKATURËS SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 10/1 të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin unanimit të anëtarëve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, Kolegji,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë e pandarë e tij.
2. Ngarkohen Kolegji i Avokaturës së Shtetit dhe Sekretariati Teknik i tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT



RREGULLORE E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOLEGJIT TË
AVOKATURËS SË SHETIT

PJESA E PARË
ORGANIZIMI I KOLEGJIT TË AVOKATURËS SË SHETIT

Kreu I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores

Kjo Rregullore disiplinon organizimin dhe funksionimin e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si dhe të drejtat e Krytarit dhe Antarve të saj, bazuar në nenin 10/1 të ligjit 10018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, të ndryshuar si dhe në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit.

Neni 2

Interpretimi

1. Zgjidhja e çështjeve që kanë të bëjnë me aplikimin dhe interpretimin e kësaj Rregulloreje, jashtë mbledhjes së Kolegjit i delegohet Kryetarit të Kolegjit njëherazi edhe Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
2. Vendimarrja për të gjitha çështjet që do të lindin gjatë zhvillimit të mbledhjeve të Kolegjit dhe që nuk janë të parashikuara në këtë Rregullore, i përket Kryetarit njëherazi Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Neni 3

Përbërja e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit

1. Kolegji i Avokaturës së Shtetit kryesohet nga Kryetari që është Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe përbëhet nga 6 avokatë shteti në cilësinë e antarve të emëruar si të tillë me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm me mandat 2 vjeçar.
2. Kolegji i Avokaturës së Shtetit asistohet në veprimtarinë e tij nga Sekretariati Teknik.

3. Me kërkesën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, në mbledhjet e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, mund të marrin pjesë përfaqësues të personave juridik apo avokatë të tjerë të shtetit që kanë njohuri mbi çështjen objekt gjykimi në Kolegj.

Neni 4

Ushtrimi i funksionit të Antarëve të Kolegjit

1. Antarët e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit fillojnë ushtrimin e funksionit të tyre me njoftimin e Urdhërit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për emërimin si të tillë.
2. Antarët e Kolegjit të Avokaturës janë të detyruar të sigurojnë prezencën e tyre në mbledhjet e Kolegjit, të paraqiten të përgatitur mbi çështjet e rendit të ditës dhe të ofrojnë qëndrimin dhe eksperiencën për gjatë diskutimeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij funksioni.

Neni 5

Kohëzgjatja e mandatit të Antarëve të Kolegjit

1. Antari i Kolegjit të Avokaturës ushtron funksionin e tij për dy vjet, deri në riemërimin e tij ose emërimin e një antari të ri pasardhës nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.
2. Mandati i Antarit të Kolegjit të Avokaturës mbaron para afatit kur verifikohet një nga pikat e parashikuara në nenin 26 pika 1 e ligjit 10018, datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit” të ndryshuar ose me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm për lirimin nga kjo detyrë.

Kreu II

KRYETARI DHE SEKRETARIATI TEKNIK

Neni 6

Funksioni i Kryetarit të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit

1. Kryetari i Kolegjit ka detyrë kryesore të kujdeset për zhvillimin e mbledhjeve të Kolegjit, për të drejtat dhe prerogativat e antarve, duke garantuar ushtrimin efektiv të funksionit të tyre, si dhe zbatimin dhe interpretimin korrekt të kësaj Rregulloreje.
2. Kryetari përfaqëson Kolegjin, thërret mbledhjet e Kolegjit dhe i ndihmuar nga Sekretariati Teknik, drejton me paanshmëri dhe barazi mbledhjet dhe diskutimet. Gjatë mbledhjeve, saktëson çështjet për të cilat do të votohet, jep të drejtën e fjalës dhe lexon rezultatet e votimeve.
3. Kryetari vendos paraprakisht për datën, orën dhe rendin e mbledhjes së radhës.

4. Kryetari drejton mbledhjen e Kolegjit dhe kur e sheh të nevojshme thërret dhe avokatë shteti të tjerë apo Kryetarët e Zyrave për tema/problem/çështje të mbarevajtjes së punës së Avokaturës së Shtetit.
5. Kryetari lexon korrespondencën që i dërgohet Kolegjit dhe bën delegimin përkatës tek Sekretariati Teknik për konsiderim të mëtejshëm.

Neni 7

Sekretariati Teknik i Kolegjit të Avokaturës së Shtetit

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, me urdhër, emëron si pjesë të Sekretariatit Teknik, jurist nga zyra e juristave pranë Zyrës Qëndrore të Avokaturës së Shtetit.
2. Sekretariati Teknik i Kolegjit përgjigjet për mbajtjen e dokumentacionit zyrtar të Kolegjit, ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve, shpalljen dhe publikimin e njoftimeve dhe akteve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, përgatitjen e mbledhjeve të Kolegjit dhe mbikqyr respektimin e kësaj Rregullore.
3. Sekretariati Teknik i Kolegjit merr detyra specifike nga Kryetari i Kolegjit, bashkëpunon me Kryetarët e Zyrave dhe me çdo avokat shteti për problematika apo çështje që ata duan t'i bëjnë pjesë të diskutimeve në rendin e ditës të Kolegjit.
4. Sekretariati Teknik i Kolegjit bën me dije Kryetarin verbalisht, me shkrim ose elektronikisht për problemet që lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre apo për çdo lloj kërkesë të ardhur nga Kryetarët e Zyrave ose çdo avokat shteti për problematika apo çështje që ata duan t'i bëjnë pjesë të diskutimeve në rendin e ditës të Kolegjit.
4. Sekretariati Teknik i Kolegjit ndihmon Kryetarin gjatë zhvillimit të mbledhjeve të Kolegjit.
5. Sekretariati i Teknik i Kolegjit mban regjistrin elektronik të vendimeve ku përfshihet edhe hyrja në fuqi e tyre, duke specifikuar edhe llojin e aktit.

Neni 8

Detyrat e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit

1. Kolegji i Avokaturës së Shtetit ushtron këto detyra:
 - a) jep këshilla për çështje të një rëndësie të veçantë për interesat e shtetit dhe miraton strategji të mbrojtjes për këto raste;
 - b) jep udhëzime të përgjithshme për bashkërendimin dhe trajtimin e çështjeve, në kuadër të dhënies së asistencës juridike;

- c) merr vendime me qëllim unifikimin e procedurave që duhet të ndjekin avokatët e shtetit për tipologji të caktuara çështjesh.
- d) zgjidh, pasi ka dëgjuar të interesuarit, papajtueshmëritë e opinioneve që lindin në trajtimin e çështjeve gjyqësore në proces ose në raste të Kolegjimeve;
- e) ushtron çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

2. Përveç detyrave të përcaktuara në pikën 1 mësipër, Kolegji ka edhe këto funksione:

- a) shqyrton problematika, tema, analiza, dhe studime e sqarime të paraqitura nga Kryetarët e Zyrave ose çdo avokat shteti për problematika apo çështje që ata duan ti bëjnë pjesë të diskutimeve në rendin e ditës të Kolegjit
- b) shqyrton të gjitha çështjet e paraqitura në rendin e ditës, jep mendime të argumentuara për ligjshmërinë ose papajtueshmërinë ligjore të tyre apo veprimeve/mosveprimeve të realizuara në kuadër të saj.

Kreu III

TË DREJTAT DHE INICIATIVAT E KRYETARIT DHE ANTARËVE TË KOLEGJIT

Neni 9

E drejta e informimit

1. Kryetari dhe Antarët e Kolegjit të Avokaturës të Shtetit që duan të marrin informacione të nevojshme më të detajuara apo specifike për kryerjen e funksionit gjatë mandatit të tyre, i drejtohen në çdo kohë Sekretarit Teknik, por edhe Kryetarit të Kolegjit, për aktet/çështjet për të cilat Kolegji duhet të shprehet.
2. E drejta dhe konsultimi vlen për të gjitha aktet e administratës së Avokaturës së Shtetit, me përjashtim kur ka një kufizim ligjor mbi to.
3. Antari i Kolegjit ka të drejtë të marrë në çdo kohë kopje të akteve që i duhen për ta ndihmuar atë në trajtimin e çështjeve në Kolegj. Të gjitha kopjet e akteve jepen nga Sekretariati Teknik duke bërë të qartë se përdorimi i tyre është i limituar në ushtrimin e të drejtave të lidhura me detyrën që ai kryen.

Neni 10

E drejta e iniciativës

1. Kryetari dhe secili nga Antarët e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit ka të drejtën e iniciativës për çdo argument apo temë për diskutim pranë Kolegjit.
2. E drejta e iniciativës ushtrohet nëpërmjet paraqitjes pranë Sekretariatit Teknik të p/vendimeve dhe amendamenteve, pyetjeve, propozimeve apo relacioneve, relativimin e të cilave duhet ta realizojë vetë propozuesi i iniciativës.
3. Kryetari dhe secili nga antarët e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, që ushtrojnë të drejtën e përcaktuar në pikën 1 mësipër, duhet që propozimin e tyre për diskutimin e një çështje konkrete ta bëjnë nëse çështja plotëson të paktën njëri nga kushtet e mëposhte:
 - a) Vlera e çështjes të jetë mbi 2 milion lekë
 - b) Dy gjykata me juridiksion të ndryshëm për të njëjtin objekt padie kanë dhënë vendim të ndryshëm
 - c) Nevojën për unifikimin e qëndrimit për të njëjtin objekt gjykimi për avokatët e shtetit të njëjtës ministri.
 - d) Nevojën për unifikimin e qëndrimit për të njëjtin objekt gjykimi për avokatët e shtetit në të gjithë nivelet
 - e) Raste të praktikës ku ka qëndrime të ndryshme midis institucionit shtetëror dhe avokaturës së shtetit
 - f) Raste të tjera të ngjashme për të cilat Vendimi i Kolegjit do të ndikonte në vijueshmërinë e procedurave administrative, gjyqësore e ligjore të Avokaturës së Shtetit.

Neni 11

E drejta për të mbledhur Kolegjin

1. Si rregull Kolegji i Avokaturës së Shtetit mbledhet me kërkesë të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit minimalisht një herë në muaj.
2. Kërkesa për të mbledhur Kolegjin, mund të vijë nga secili Antar i Kolegjit, kërkesë e cila i drejtohet Kryetarit të Kolegjit dhe përmban arsyet dhe argumentet që do të trajtohen në mbledhje.
3. Në rastet e një kërkesë sipas pikës 2 mësipër, Kryetari mbledh Kolegjin brenda 10 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.

Neni 12

Detyrimi për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisioneve

1. Çdo Antar i Kolegjit është i detyruar të marrë pjesë në mbledhjet e Kolegjit, të kërkojë fjalën, të bëjë propozime, të paraqesë amendamente dhe t'i mbrojë ato dhe gjithnjë me të drejtë vote.
2. Antari i Kolegjit mund të mungojë në mbledhje vetëm për raste të justifikuara dhe të miratuara paraprakisht nga ana e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Neni 13

E drejta për pyetje

1. Çdo Antar i Kolegjit mund të paraqesë pyetje mbi çështje që kanë lidhje me rendin e ditës me qëllim sqarimin më të mirë të tyre dhe për pasojë një vendimarrje më korrekte.
2. Pyetjet e lindura gjatë studimit të rasteve të paraqitura në rend dite, mund të paraqiten nga Antarët e Kolegjit edhe përpara mbledhjes duke ia përcjellë me shkrim ose elektronikisht Sekretariatit Teknik.

Neni 14

E drejta e abstenimit

1. Kryetari ose Antarët e Kolegjit nuk lejohen të marrin pjesë në diskutime dhe votime në rastet kur kanë një interes direkt personal ose të famijarëve të afërt, me çështjen objekt shqyrtimi.
2. Largimi nga salla e mbledhjes për aryen e përmendur në pikën 1 më sipër, pasqyrohet nga Sekretariati Teknik në procesverbalin e mbledhjes.

Neni 15

Rendi i ditës të Kolegjit

1. Rendi i ditës hartohet nga Sekretariati Teknik, pas miratimit praraparak të Kryetarit, duke pasur parasysh prioritetet e paraqitura nga Kryetari dhe nga propozimet e Antarëve të Kolegjit, Kryetarët e Zyrave apo çdo avokat shteti.
2. Rendi i ditës i njoftohet Kryetarit dhe secilit prej Antarëve të Kolegjit përmes postës së tij elektronike të paktën 7 ditë përpara datës së mbledhjes së radhës.
3. Në raste urgjente, njoftimi dorëzohet jo më vonë se 24 orë para zhvillimit të mbledhjes. Megjithatë, në rast se kërkohet nga shumica e Antarëve pjesëmarrës të Kolegjit dhe çështjet

objekt shqyrtimi nuk janë urgjente, vendimet mund të merren ditën tjetër (në këtë rast mbledhja ndërpritet për të vazhduar ditën tjetër).

4. Rendi i ditës, kur ka shtesa për çështje urgjente, miratohet nga Kolegji në fillim të mbledhjes me votim.

Kreu IV

PROCEDURA E PROPOZIMEVE PËR TRAJTIM TË ÇËSHTJEVE NË KOLEGJ

Neni 16

E drejta e propozimit të çështjes për trajtim nga Kolegji

1. Kryetari dhe secili nga antarët e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit ka të drejtën e iniciativës për propozimin e çështjeve për diskutim pranë Kolegjit.
2. Të drejtën për propozimin e çështjeve për diskutim pranë Kolegjit e ka çdo avokat shteti.
3. E drejta e propozimit të çështjes për diskutim është e pa kufizuar në kohë me përjashtim të rastit kur ajo nuk është më aktuale.

Neni 17

Procedura e paraqitjes së propozimit për diskutim dhe trajtimi I tij

1. Kryetari dhe secili nga Antarët e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit ka të drejtën e iniciativës për propozimin e çështjeve për diskutim të shkruar dorazi, në rrugë zyrtare ose në rrugë elektronike pranë Sekretariatit Teknik, por mund të bëjnë propozim edhe direkt në mbledhjen e Kolegjit.
2. Në rastin e propozimit nga antarët direkt në mbledhje, Kryetari e konsulton me antarët e tjerë dhe me votim vendosen nëse çështja do futet në rendin e ditës së asaj mbledhjeje.
3. Çdo avokat shteti, të drejtën e propozimit të çështjeve për diskutim nga Kolegji duhet ta paraqesi në çdo kohë me shkrim dorazi, në rrugë zyrtare ose në rrugë elektronike pranë Sekretariatit Teknik, në adresën sekretariatiteknikkolegjitash@gmail.com.
4. Propozimi përveç se duhet të plotësojë një nga kushtet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 10 të kësaj Rregulloreje, duhet të bëjë edhe një përshkrim të situatës dhe shqetësimit të konstatuar.
5. Pas rregjistrimit të propozimit nga ana e Sekretariatit Teknik në një rregjistër të posaçëm, i njoftohet Kryetarit i cili ia delegon për vlerësim njërit prej Antarve të Kolegjit nëse

propozimi duhet të bëhet pjesë e trajtimit dhe diskutimit nga Kolegji. Nëse Antari, pas marrjes kontakt me avokatin e shtetit që ka bërë propozimin vlerëson që propozimi duhet të futet në rend dite, në bashkëpunim me avokatin propozues harton relatimin e propozimit, në të kundërt Antari i kthen përgjigje avokatit propozues për arësyet e mos trajtimit të propozimit në Kolegji.

6. Relatimi i propozimit në Kolegji do të realizohet nga antari të cilit i është deleguar nga Kryetari dhe/ose avokati përkatës që ka bërë propozimin.

Kreu V

ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOLEGJIT

Neni 18

Organizimi i mbledhjeve të Kolegjit

1. Mbledhjet e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, si rregull, zhvillohen në sallën përkatëse të mbledhjeve në Zyrën Qëndrore të Avokaturës së Shtetit.
2. Mbledhjet e Kolegjit nuk janë të hapura për publikun
3. Mbledhjet e Kolegjit si rregull bëhen ditën e premte të javës së fundit të çdo muaji, por mund të organizohen edhe një ditë tjetër të javës kur vendoset kështu nga Kryetari.
4. Kolegji nuk mund të zhvillojë mbledhjen e tij në rast se nuk janë prezent më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të Antarëve të Kolegjit. Verifikimi i prezencës së antarëve të Kolegjit në sallë bëhet nga Sekretariati Teknik dhe reflektohet në proçverbalin e mbledhjes.
5. Mbledhjen e hap dhe e drejton gjithnjë Kryetari i Kolegjit, në mungesë të tij e drejton Antari i Kolegjit më i vjetër në moshë, i pranishëm në sallë deri në kthimin e Kryetarit të Kolegjit.
6. Asnjë Antar i Kolegjit nuk ka të drejtë të diskutojë, pa iu dhënë fjala nga drejtuesi i mbledhjes. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës.
7. Diskutimet e mbledhjes zhvillohen sipas Rendit të ditës të përcaktuar, megjithatë Kryetari i Kolegjit, apo secili nga Antarët mund të kërkojë që renditja të ndryshojë, duke treguar edhe arsyet e kërkesës. Në qoftë se nuk ka kundërshtime nga Antarët e tjerë, propozimi quhet i pranuar.

8. Me propozimin e Kryetarit apo secilit nga antarët, Kolegji mund të vendosë të diskutojë dhe të votojë për çështje që nuk janë në rendin e ditës, me kusht që të mos ketë kundërshtime nga shumica e Antarëve të tjerë.
9. Antarit nuk mund t'i ndërpritet fjala por, Kryetari mund t'i kërkojë të përfundojë diskutimin ose t'i përmbahet temës për të cilën diskutohet.
10. Antarët në mbledhje duhet të kenë veshje dhe sjellje dinjitoze dhe korrekte, të përshtatshme për funksionin publik që ata kanë, qëndrojnë në vendin e tyre, përdorin gjuhë korrekte për funksionin, duke respektuar kolegët dhe institucionet.
11. Nuk lejohen telefonë celularë të ndezur gjatë zhvillimit të mbledhjes nga antarët apo të ftuarit.
12. Nuk lejohet pirja e duhanit në sallën e mbledhjes.

Neni 19

Pjesëmarrja e personave të tjerë

1. Në mbledhjet e Kolegjit, me kërkesë të Kryetarit, mund të marrin pjesë:
 - a) Përfaqësues të personave juridike
 - b) Avokatë shtetit
 - c) Punonjës të administratës së Avokaturës së Shtetit
 - d) Çdo subjekt tjetër i cili zotëron njohuri në një çështje të caktuar.
2. Subjektet të përcaktuar në pikën 1 mësipërm mund t'u kërkojë pjesëmarrja në mbledhje për të siguruar informacion apo shpjegime. Atyre u jepet fjala sa herë kërkojnë të plotësojnë informacionin për të cilin janë thirrur. Arësyeja që mund të ftohen në mbledhjet e Kolegjit
3. Të ftuarit që marrin pjesë në mbledhjet e Kolegjit, duhet të qëndrojnë në hapësirën e sallës së rezervuar për këtë qëllim, të mbajnë qëndrim korrekt, të mos japë asnjë mendim për çështjet në diskutim nga Kolegji, opinionet e shprehura nga antarët, apo vendimet e Kolegjit dhe të ruajnë kofidencialitetin e mbledhjes.

Kreu VI

DISKUTIMET, VOTIMI DHE ZBARDHJA E PROCESVERBALIT DHE VENDIMIT

Neni 20

Diskutimet e propozimeve

1. Kryetari hedh në diskutim çështjet sipas rendit të ditës të njoftuar.
2. Antari apo avokati që ka bërë propozimin, me kërkesën e Kryetarit, relatojnë rreth çështjes që diskutohet. Kur materiali i tyre është me shkrim ai depozitohet tek Sekretariati Teknik pas leximit përpara Kolegjit.
3. Pas relacionit të paraqitur nga relatori, fjalën e marrin Kryetari apo antarët e tjerë të Kolegjit duke vijuar me diskutime përkatëse.

Neni 21

Çështje të pezulluara dhe çështje të tërhequra

1. Dokumentacioni dhe/ose informacioni përkatës për çështje të pezulluara, apo për të cilat kërkohet të shtyhet diskutimi në një mbledhje tjetër, apo çështje të cilat tërhiqen nga rendi i ditës, mund të kërkohen nga çdo antar para se të fillojë diskutimi i asaj çështje.
2. Për pezullimin ose tërheqjen e çështjes vendos Kryetari, edhe në rast se ka kundërshtime, Kolegji.

Neni 22

Votimi

1. Pasi mbyllet diskutimi, për një çështje të caktuar, Kryetari deklaron fillimin e votimit.
2. Kryetari apo antarët e Kolegjit të cilët nuk marrin pjesë në votim, konsiderohen se abstenojnë në qoftë se nuk largohen nga mbledhja.
3. Asnjë nuk mund të marrë fjalën nga momenti kur Kryetari deklaron të hapur votimin, deri në shpalljen e rezultatit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet fjala për zbatimin dhe respektimin e rregullores gjatë votimit që po kryhet.
4. Në përfundim të votimit, akti miratohet atëherë kur votohet nga shumica e antarëve prezentë në mbledhje. Në funksion të kësaj pike, numri i antarve prezentë në mbledhje do të përfshijë edhe numrin e antarëve të cilët kanë deklaruar se nuk marrin pjesë në votim, por megjithatë ndodhen në sallë kur fillon votimi.
5. Vendimarrja realizohet me shumicë të votave të të gjithë antarëve të Kolegjit të pranishëm në sallë në momentin e votimit.
6. Votimi është personal. E drejta e votës nuk mund të delegohet.
7. Aktet votohen me votim të hapur me ngritjen e dorës, ose me apel nominal me thirrjen e emrit të antarit.

8. Nuk ka ndërprerje të votimit. Kryetari i Kolegjit ka të drejtë të ndërpresë, vetëm në rast se vëren shkelje të rënda të kësaj Rregulloreje.
9. Kur nga rezultati i votimit, numri i votave “pro” është i barabartë me numrin e votave “kundër”, votimi përsëritet.
10. Kur konstatohen parregullsi dhe kryesisht kur numri i votave është i ndryshëm nga numri i antarve që votojnë, Kryetari shpall pavlefshmërinë e votimit dhe menjëherë përsërit votimin.
11. Antarët që kanë konflikt interesash në lidhje me aktin që miratohet, abstenojnë, duke deklaruar votën dhe arsyen e abstenimit.

Neni 23

Procesverbali i mbledhjes

1. Procesverbali i mbledhjes përmban pikat kryesore të diskutimeve, mënyrat dhe procedurat e votimit, numrin e votave pro, kundër dhe abstenim, datën, orën dhe vendin e mbledhjes duke shënuar jo vetëm emrat e antarëve pjesëmarrës, por edhe të atyre që mungojnë në mbledhje.
2. Të gjitha propozimet, përveç atyre të tërhequra, emrat e propozuesve të tyre.
3. Krahas mbajtjes së protokollit me shkrim, mund të ndodhë që çdo mbledhje të rregjistrohet me rregjistrues të posaçëm dhe zbardhja të bëhet mbi bazën e regjistrimit.
4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari, Sekretariati Teknik, anetaret e Kolegjit brenda 2 ditësh nga përfundimi i saj. Në rastet kur një antar, ka vërejtje për mbajtjen e tij, ai mund të depozitojë me shkrim vërejtjet përkatëse, ose t'i shkruajë ato në procesverbal.
5. Procesverbali mbahet nga Sekretariati Teknik, i cili, pas përfundimit të mbledhjes dhe nënshkrimit të antarve, e administron atë.
6. Zbardhja e akteve bëhet në mënyrë shkresore, format A4, bazuar në procesverbalin e mbledhjes. Akti konsiderohet i zbardhur në momentin kur firmoset nga të gjithë antarët e pranishëm në mbledhje.

Neni 24

Vendimi

1. Vendimi i Kolegjit, zbardhet nga Sekretariati Teknik në formë të shkruar dhe merr fuqi ligjore kur nënshkruhet nga Kryetari dhe mbi të vendoset vula e institucionit të Avokaturës së Shtetit.
2. Vendimi shoqërohet nga procesverbali i mbledhjes sipas nenit 23 mësipërm dhe pas hyrjes në fuqi protokollohet nga arkiv protokolli i Avokaturës së Shtetit dhe i njoftohet të avokatëve të shtetit/zyrave vendore përkatëse të interesuara nga Sekretariati Teknik brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
3. Vendimi i Kolegjit njoftohet elektronikisht nga Sekretariati Teknik
 - a) tek të gjithë avokatët e shtetit kur përcakton rregulla/orjentime me karakter të përgjithshëm;
 - b) vetëm tek avokatët e shtetit të interesuar për çështje konkrete kur përcakton rregulla/orjentime me karakter të veçantë;
4. Format i vendimit të kolegjit do të jetë sipas formatit bashkëlidhur shtojcës nr.1 të kësaj rregulloreje.

Kreu VII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 25

Ndryshimi i rregullores

1. Kryetari i Kolegjit, apo 2 antarë kanë të drejtë të paraqesin propozime për ndryshimin e kësaj Rregulloreje.
2. Ndryshimi i Rregullores miratohet me vendim të Kolegjit.

Neni 26

Shpallja dhe hyrja në fuqi e Rregullores

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të vendimit të miratimit të saj nga Kolegji, administrohet nga Sekretariati Teknik dhe i vihet në dispozicion të gjithë antarëve të Kolegjit, si dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Avokaturës së Shtetit.

Shtojca nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AVOKATURA E SHETIT
KOLEGJI I AVOKATURËS SË SHETIT**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.201_

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

Në mbështetje të nenit 10/1 të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, të nenit 24 të “Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit”, me propozimin e shumicës së antarëve të Kolegjit të Avokaturës së Shtetit, Kolegji,

VENDOSI:

1. _____.
2. Ngarkohen Kolegji i Avokaturës së Shtetit dhe Sekretariati Teknik i tij për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHETIT

Artur METANI